

VENDIM
Nr. 138, datë 2.3.2022

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT, ME SHKËMBIM NOTASH, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT EVROPIAN, PËR PROJEKTIN “EU4CULTURE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12 e 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, me shkëmbim notash, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për projektin “EU4CULTURE”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



Znj. Elva Margariti
Ministre
Ministria e Kulturës
Tiranë – Shqipëri

Tiranë, 20 shtator 2021
Ares (2021) 5740733

Lënda: Programi EU4 Culture – Notë Verbale e Qeverisë së Shqipërisë

E nderuar ministre Margariti,

Në kuadër të Programit të Kulturës EU4, UNOPS-i ka kërkuar mbështetjen e delegacionit të BE-së për të iniciuar procesin, në lidhje me përjashtimin e TVSH-së për aktivitetet e programit.

Menduam se qasja që do të ndiqet mund të jetë e ngjashme me atë të zbatuar nga Qeveria e Shqipërisë për programin *EU4 Schools*, sepse të dyja programet si *EU4 Schools* dhe *EU4 Culture* janë pjesë e së njëjtës paketë të ofruar nga BE-ja për të mbështetur procesin e rindërtimit pas tërmetit të nëntorit 2019.

Siç është rënë dakord për projektin *EU4 Schools*, ne po ia drejtojmë këtë notë qeverisë së Shqipërisë, duke propozuar parimet e mëposhtme, të cilat u ranë dakord fillimisht ndërmjet palëve me nismën e Qeverisë së Shqipërisë për *EU4 Schools*, zbatimin e të cilave do të garantojë suksesin e projektit, duke shkuar përtej përjashtimeve fiskale:

1. Projekti do të zbatohet në koordinim të plotë me Qeverinë e Shqipërisë dhe administratën publike.

2. Prokurimi, ndërtimi dhe zbatimin e projektit do të realizohen nga UNOPS-i, në përputhje me standardet shqiptare dhe të BE-së.

3. Veprimtaritë e ndërtimit dhe zbatimit do të mbikëqyren nga UNOPS-i dhe rezultatet do t'i dorëzohen Ministrisë së Kulturës.

4. Të gjitha detyrimet e palëve të treta në kantiere dhe të gjitha detyrimet ligjore mbeten përgjegjësi e autoriteteve kompetente në Republikën e Shqipërisë, përkatësisht Ministrisë së Kulturës.

5. Problemet e zonave dhe të pronësisë, nëse ka, në lidhje me tokat, do të zgjidhen nga organet kompetente.

6. Ministria e Kulturës dhe/ose Bashkitë do të ofrojnë dokumentacionin e nevojshëm (lejet, licencat e autorizimit etj.) për zbatimin e punimeve.

7. Granti që siguron burimet për zbatimin e projektit, u nënshtrohet të gjitha dispozitave ligjore në fuqi, për përjashtimet përkatëse fiskale, si përjashtimi i TVSH-së, gjatë ekzekutimit të kontratës, në kuadër të procesit të rindërtimit nga fatkeqësitë natyrore.

8. Ministria e Kulturës merr përsipër të iniciojë dhe të ndjekë me Këshillin e Ministrave nënshkrimin e një vendimi të Këshillit të Ministrave, për programin *EU4 Culture*, për të zyrarizuar notat e shkëmbyera dhe marrëveshjen e arritur.

9. Ministria e Kulturës merr përsipër të ndjekë Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe të sigurojë se do të lehtësojë menjëherë proceset e përjashtimit të TVSH-së me furnizuesit UNOPS.

Do të isha mirënjohës, nëse mund të konfirmoni dakordësinë tuaj me parimet e lartpërmendura, duke iu përgjigjur kësaj letre.

Një shkëmbim i tillë letrash mes nesh do të përbëjë një marrëveshje zyrtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, në lidhje me programin *EU4Culture*, i cili do të hyjë në fuqi në datën e marrjes nga Bashkimi Evropian të njoftimit me shkrim nga pala shqiptare.

LUIGI SORECA

Bashkëlidhur: VKM-ja nr. 804, 30 shtator 2020 dhe nr. 635, 29 korrik 2020.

Për dijeni: Z. Arben Ahmetaj, zëvendëskryeministër, ministër Shteti për Programin e Reformave dhe Rindërtimit

Znj. Delina Ibrahimaj, zëvendëskryeministër e Financave dhe Ekonomisë

Znj. Pamela Lama, drejtore lokale e Zyrës UNOPS



Znj. Elva Margariti
Ministre
Ministria e Kulturës
Tiranë – Shqipëri

Tiranë, 13.10.2021
Ares (2021) 5740733

Lënda: Programi *EU4 Culture* - Notë Verbale e Qeverisë së Shqipërisë

Referenca: Nota Verbale e Bashkimit Evropian, 20 shtator 2021

Kthim përgjigje e Ministrisë së Kulturës, 1 tetor 2021

E nderuar ministre Margariti,

Më lejoni t'ju falënderoj për fillimin e procesit të përjashtimit nga TVSH-ja për aktivitetet e programit *EU4 Culture*.

Pas sqarimeve që ndatë me ne në përgjigjen tuaj të datës 1 tetor 2021, ne kemi rishikuar pikat e mëposhtme, si më poshtë:

1. Të gjitha detyrimet e TVSH-së dhe detyrime të tjera tatimore të palëve të treta në kantieret e ndërtimit dhe të gjitha detyrimet ligjore do të mbeten përgjegjësi e autoriteteve kompetente në Republikën e Shqipërisë.

2. Ministria e Kulturës dhe/ose bashkitë do të lehtësojnë procedurat për UNOPS-in, kur aplikojnë që të marrin dokumentacionin e nevojshëm (lejet, licencat e autorizimit etj.) për zbatimin e punimeve.

Në vijim të kërkesës suaj, lutemi gjeni bashkëlidhur listën e monumenteve të dakordësuara/në diskutim që të jenë pjesë e programit të kulturës EU4.

Në pritje të përfundimit të procesit.

LUIGI SORECA

Bashkëlidhur: Lista e siteve për Programin *EU4 Culture*.

Për dijeni: Z. Arben Ahmetaj, zëvendëskryeministër, ministër Shteti për Programin e Reformave dhe Rindërtimit

Znj. Delina Ibrahimaj, zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Znj. Pamela Lama, drejtore lokale e Zyrës UNOPS



Tiranë, 2.11.2021

LISTA E SITEVE ME PREVENTIVË

Në cilësinë e anëtarëve të Komitetit Drejtues të Projektit për projektin *EU4Culture* – Rivitalizimi i Trashëgimisë Kulturore të Shqipërisë në Përgjigje të Tërmetit në Shqipëri të vitit 2019, ne po miratojmë një listë të vendeve, të propozuara për t'iu nënshtruar ndërhyrjeve konservuese dhe rivitalizuese.

Lista e preventivëve për ndërhyrjet në secilin prej siteve.

Siti/kontrata	Vlerësimi (EURO)	TVSH (EURO)	TOTALI (EURO)
Shërbimet Konsultative të Dizajnit	1,176,100.00	235,220.00	1,411,320.00
Planet e menaxhimit të trashëgimisë kulturore	485,000.00	97,000.00	582,000.00
Materiali dokumentues	100,000.00	20,000.00	120,000.00
Krijimi i përmbajtjes për interpretim	1,000,000.00	200,000.00	1,200,000.00
Komunikime, evente	400,000.00	80,000.00	480,000.00
Shërbimet dhe produktet e vizibilitetit	200,000.00	40,000.00	240,000.00
Monitorimi dhe vlerësimi	100,000.00	20,000.00	120,000.00
Grantet/impakti Led/mbështetja	1,000,000.00	320,000.00	1,920,000.00
Mozaiku i Muzeut Historik Kombëtar	668,000.00	133,600.00	801,600.00
Kisha e Manastirit Rubik	108,200.00	21,640.00	129,840.00
Kisha e Shën Andoninit në Rodon	89,100.00	17,820.00	106,920.00

Muzeu Etnografik Krujë	675,000.00	135,000.00	810,000.00
Ura Kurcajt	120,000.00	24,000.00	144,000.00
Torra Veneciane, Durrës	600,000.00	120,000.00	720,000.00
Muzeu Etnografik i Kavajës	600,000.00	120,000.00	720,000.00
Hamami i Durrësit	250,000.00	50,000.00	300,000.00
Teatri Kombëtar i Kukullave	2,650,000.00	520,000.00	3,120,000.00
Kalaja e Lezhës	1,500,000.00	300,000.00	1,800,000.00
Muzeu Arkeologjik, Durrës	2,650,000.00	530,000.00	3,180,000.00
Kalaja e Bashтовës	1,200,000.00	240,000.00	1,440,000.00
Muzeu Historik Kombëtar	14,000,000.00	2,800,000.00	16,800,000.00
Muzeu Etnografik i Durrësit	200,000.00	40,000.00	240,000.00
Kalaja e Ishmit dhe ndërtesa ngjitur kalasë	300,000.00	60,000.00	360,000.00
Akademia Kombëtare e Shkencave	380,000.00	76,000.00	456,000.00
Gërmadhat e Kishës së Shën Marisë	100,000.00	20,000.00	120,000.00
Porto-Romano, Durrës	150,000.00	30,000.00	180,000.00
Biblioteka Kombëtare, Tiranë	700,000.00	140,000.00	840,000.00
Ndërtesa e Institucionit të ish-të Persekutuarve	300,000.00	60,000.00	360,000.00
Ish-Arqipeshkvia	250,000.00	50,000.00	300,000.00
Ish-Lidhja e Shkrimtarëve	250,000.00	50,000.00	300,000.00
Ministria e Kulturës	500,000.00	100,000.00	600,000.00
Galeria Kombëtare e Arteve	120,000.00	24,000.00	144,000.00
Fondi i Bibliotekës Kombëtare	360,000.00	72,000.00	432,000.00
Arkivi Kombëtar i Filmit	100,000.00	20,000.00	120,000.00
Arkivi Teknik IKTK	200,000.00	40,000.00	240,000.00
Banesa Ahmet Cuni, Murrizë	100,000.00	20,000.00	120,000.00
Selia Bashkimi, Tiranë	100,000.00	20,000.00	120,000.00
Muzeu Etnografik Lezhë	250,000.00	50,000.00	300,000.00
Banesa Preng Lleshi	60,000.00	12,000.00	72,000.00
Shtëpitë brenda Kalasë së Krujës	450,000.00	90,000.00	540,000.00
UNOPS	5,008,600.00	0	5,008,600.00
TOTALI I GRANTIT	40,000,000.00	6,998,280.00	46,988,280.00

Preventivi aktual total do të rishikohet me përfundimin e studimit dhe detajet e projekteve dhe pas finalizimit të prokurimeve.

SH. E TIJ AMBASADOR I BASHKIMIT EVROPIAN
Luigi Soreca
(nënshkrimi)

SH. E SAJ MINISTRE E KULTURËS
Elva Margariti
(nënshkrimi)

KRYETARE E UNOPS-it
Dr. Pamela Lama
(nënshkrimi)